

Ti je nën moshën 18 vjeç dhe ndihesh në rrezik ?




Në Francë, **të gjithë fëmijët mbrohen** nga dhuna dhe shfrytëzimi

Nëse **ndihesh në rrezik, ose i(e) detyruar të bësh gjera që nuk do t'i bësh**, të cilat të venë në siklet apo që janë të ndaluara, nëse je i(e) kërcënuar, që të kanë dhunuar.



Apo **nëse një person ose një grup të detyron** të punosh, të lypësh, të vjedhësh ose të kryesh një krim, të bësh marrëdhënie seksuale, të paguash një borxh ose të marrësh drogë.



Apo nëse je në Francë **pa prindërit ose tutorët e tu**.

Bisedo për këto me një profesionist: punonjës policie, shoqata, mësues, mjekë, edukatorë, punonjës socialë, avokatë, gjyqtarë...



Është puna e tyre **që të mbrojnë.**

Ke të drejtë që të marrësh

ndihmë dhe t'u **largohesh njerëzve që të duan të keqen.** Nëse ty të kanë detyruar të bësh diçka të paligjshme, ti nuk mund të ndëshkohesh për këtë.



Ti mund të lidhesh me **policinë dhe xhandarmërinë** duke thirrur **numrin 17 (frëngjisht)**. Mund të telefonosh gjithashtu numrin e **Allô Enfance en danger, 119** Alo Fëmijë

në rrezik, (thirrje falas dhe anonime 24 orë/ në 24, frëngjisht dhe përkthim).

Nëse je më pak se 18 vjeç, je në Francë pa prindërit apo tutorët e tu




Sapo të mbërrish në Francë, ti ke të drejtë të jesh **i mbrojtur nga shteti**, të strehohesh dhe ndihmohesh falas të paktën deri sa të mbushësh 18 vjeç. Kjo është ajo që quhet **Ndihma Sociale për Fëmijët**.

Do të jenë një gjykatës për fëmijë dhe edukatorë që do të të ndihmojnë. Ata do të vendosin bashkë me ty dhe sipas moshës tënde, nëse ti do të vendosesh në një shtëpi kolektive, në një apartament, në një familje pritëse...



Ti mund të mjekohesh falas nga një mjek mashkull apo femër.

Shkolla është falas dhe e hapur për të gjithë fëmijët ngado që ata vijnë. Ti do të mësosh frëngjishten sipas nivelit tënd, ti do të mund të shkosh në shkollë me të rinj të tjerë të moshës tënde por do të formohesh gjithashtu për një zanaq që e zgjedh ti. **Në France, moshja ligjore për të punuar është 16 vjeç.**



Si fëmijë, ti nuk ke nevojë për letra për të qëndruar në Francë. Në varësi të nevojave të tua dhe të situatës tënde, profesionistët do të mund të ndihmojnë në përpjekjet e tua.

Nëse ke humbur anëtarë të familjes tënde, La Croix Rouge Francaise (Kryqi i Kuq Francez) mund të ndihmojë t'i gjesh ata, për të mbajtur kontaktet ose të ribashkoheni me ta.



Kontakto Kryqin e Kuq në numrin +33(0)1 44 43 12 60 ose me email recherches@croix-rouge.fr

Nëse ti je pa prindërit e tu por me anëtarë të familjes tënde (vëllezër dhe motra, gjyshër, teze, halla, xhaxhallarë, daja, kushërinj) ose të afërm:

Është e rëndësishme të kontaktoni profesionistë me qëllim që të mund të ndihmoheni: punonjës policie, shoqata, mësues, mjekë, edukatorë, punonjës socialë, avokatë , gjyqtarë...

Nëse anëtarët e familjes tënde mund të kujdesen për ty, ata do të mund të ndihmohen për këtë.

Cilat janë **shenjat** që duhet të të alarmojnë?

Qëndro vigjilent nëse një person, qoftë grua apo burrë, ose një i(e) ri(e) tjetër:

- Përpiqet të marrë letrat e tua ose dokumentet e tua të identitetit (përveç autoriteteve).
- Përpiqet për të fotografuar ty apo të marrë fotografi ose video të tuat.
- Përpiqet për të marrë telefonin tënd, kompjuterin ose çdo mjet tjetër komunikimi.
- Përpiqet për të ndarë nga familja jote ose nga të afërmit e tu.
- Të bën premtime që ti e ke vështirë t'i besosh ose që të duken të ekzagjeruara.
- Të premtan se do të japë ndihmë (transport, ushqim etj. ...) ose një mbështetje në këmbim të parave.
- Të bën të punosh por nuk të pagan ose të mban në kushte të këqija pune.



Ja disa këshilla për t'u mbrojtur :

Mbro të dhënat e tua personale dhe dokumentet e tua të identitetit:



- Të dhënat e tua personale dhe dokumentet e tua të identitetit janë elemente të rëndësishëm dhe duhet të ruhen gjithmonë në vende të sigurta dhe të fshehta.
- Bëju një foto atyre, dërgoji ato në një adresë email ose bëju një fotokopje, kjo mund të të ndihmojë në rast se i humb ato.
- Jepja ato vetëm autoriteteve zyrtare nëse ata t'i kërkojnë.
- Njerëz keqdashës mund të përpiqen të krijojnë një lidhje besimi me ty në rrjetet sociale me qëllim që të përfitojnë nga ty dhe nga situata jote.
- Asnjëherë mos i nda me të tjerët të dhënat e tua personale dhe mos prano asnjë propozim nga të panjohur në rrjetet sociale apo në faqet e internetit të pa verifikuara nëse janë të sigurta. Në Francë, faqet zyrtare të autoriteteve përfundojnë me “.gouv.fr”.



Mbaj kontaktin me të afërmit e tu:

- Qëndro në kontakt me familjen tënde, me të afërmit apo me miqtë e tu. Tregoju atyre për vështirësitë e tua.
- Nëse është e mundur, udhëto me njerëz që ti i njeh dhe tek të cilët ke besim.
- Mos prano të ndahesh nga familja jote apo nga të afërmit e tu.



- Mbaje telefonin me vete. Mëso përmendësh numrin e telefonit të një personi

të besuar dhe bini dakord për një fjalëkalimi që ti mund ta përdorësh nëse ndodhesh ndonjëherë në rrezik dhe që nuk mundesh të flasësh lirshëm.



Prano vetëm ndihmën e profesionistëve të cilët kanë një shenjë dalluese siç është një jelek ose një kartë.

- Pyet për emrat dhe informacionet zyrtare të organizatave dhe shoqatave që të japin ndihmë.




- Nëse duhet të hipësh në veturën e dikujt, bëj një foto të targës së makinës dhe dërgoja një personi tek i cili ke besim. Jepi përparësi transportit publik.

- Nëse je strehuar në shtëpinë e dikujt jashtë kanaleve zyrtare të strehimit, kërko të shohësh informacionet e këtij personi (identitetin dhe adresën) dhe tregojani ato një profesionisti.



Me kë të kontaktosh kur je i mitur?



Organizatrat që ofrojnë një ndihmë direkte për të miturit.

Collectif “Ensemble contre la traite des êtres humains”	Kolektivi është një rrjet i krijuar për një luftë më efektive kundër të gjitha formave të këtij mohimi të të drejtave njerëzore. Krijuar nga Secours Catholique në 2007, ai bashkon 28 shoqata franceze, të angazhuara në mënyrë direkte ose indirekte me viktimat.
Secours catholique - Caritas France	Ofron dëgjim, pritje, orientim dhe ndihmë për personat në rrezik dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.
Croix-Rouge française	Ofron informacion dhe orientim për personat në rrezik dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.
Hors la Rue	Identifikon dhe mbështet të miturit e huaj të pashoqëruar që ndodhen në situatë të shfrytëzimit të tyre.
Ecpat France - mission Calais	Ofron mbështetje sociale dhe ligjore për të miturit e pashoqëruar dhe të rriturit viktimë të trafikimit.
Agir Contre la Prostitution des Enfants (ACPE)	Ofron mbështetje për të miturit që janë viktimë të shfrytëzimit seksual dhe të atyre që i rrethojnë (ndihma psiko – edukative, ligjore).
L'amicale du Nid (AdN)	Ofron një bashkë- mbështetje globale për persona të mitur në situatë prostitucioni.
ALTHEA - L'Appert	Ofron pritje, dëgjim, orientim, dhe mbështetje të përbashkët për të miturit në situatë ose në rrezik prostitucioni.

Allô Enfance en Danger 119
(Alo Fëmijë në Rrezik)

Të gjitha llojet e shfrytëzimit	106 rue du Bac, 75007 Paris 06 71 00 69 90 contre.la.traitee.secours-catholique.org www.contrelatraite.org	Paris Kompetencë Kombëtare
Të gjitha llojet e shfrytëzimit	106, rue du Bac, 75007 Paris 06 71 00 69 90 genevieve.colas@secours-catholique.org www.secours-catholique.org	Paris Kompetencë Kombëtare
Të gjitha llojet e shfrytëzimit	Selia: 21 rue de la Vanne, 92100 Montrouge 07 81 96 72 49 estelle.kieferecroix-rouge.fr www.croix-rouge.fr	Paris Kompetencë Kombëtare
Të gjitha llojet e shfrytëzimit	70, rue Douy Delcupe, 93100 Montreuil 01 41 58 14 65 ; contactehorslarue.org www.horslarue.org	Paris
Të gjitha llojet e shfrytëzimit	+33 7 53 57 05 34 nga e hëna në të premtë, 10:00-17:00 - WhatsApp, gjuhët : arabisht, tigrinya, anglisht, frëngjisht), AGatoux@ecpat-france.org	Calais
Shfrytëzim seksual	14 rue Mondétour, 75001 Paris 01 40 26 91 51; contacteacpe-asso.org acpe-asso.org	Paris
Shfrytëzim seksual	Selia : 21 rue Château d'Eau, 75 010 Paris 01 44 52 56 43 ; contacteadn-asso.org Adresa të qendrave në dispozicion në : amicaledunid.org/presentation/#etablissements Webisit burimesh dedikuar: jenesuispasavendre.org	Ile-de-France, Marseille, Toulouse, Rennes, Montpellier, Lyon
Shfrytëzim seksual	8, rue du Vieux Temple, 38000 Grenoble 04 76 43 14 06 ; contactealthea38.org https://althea38.org/	Grenoble

Linja kombëtare e thirrjeve telefonike për fëmijë në rrezik, falas dhe anonime (24 orë/ 24 orë, 7 ditë/në 7, përkthim në rreth 185 gjuhë), bashkëbisedim (tchat) në linjë në allo119.gouv.fr.

